


---

# RAPORT VJETOR



# Lënda

Fakte dhe Shifra 2009	4
Editorial	5
Të veçanta dhe Sfida 2009	6
Vizioni, Misioni, Vlerat	8
Qendrat dhe Partnerët	10
Struktura NEHEMIA	12
Projekte dhe Aktivitete	14
	
Shoqata Miqtë e NEHEMIA-s	28
Projekte ndërtimi	29
Shërbime	30
Licensa dhe Regjistrime	33
Donacione dhe Financa	34
Raporti financiar 2009	35
Pasqyra e aktiviteteve	36
Pasqyra e gjendjes financiare	37
Kontakte	38



- 14 - Shërbesat frymërore
  - Shërbesat e Kishës
  - Aktivitete të tjera frymërore
  - Royal Rangers
  
- 18 - Ndihma Sociale dhe Mjekësore
  - Ndihma sociale
  - Ndihma mjekësore
  - Zhvillim komuniteti
  - adidas-NEHEMIA Challenge Cup 2009
  
- 22 - Edukimi NEHEMIA
  - Kopshtet NEHEMIA
  - Shkollat NEHEMIA
  
- 26 - Universiteti NEHEMIA





## 217 të rritur dhe 323 fëmijë

217 të rritur dhe 323 fëmijë marrin pjesë rregullisht në shërbesat e kishës NEHEMIA.

## 3,856 vizita në familje

101 familje dhe individë, veçanërisht të moshuar dhe njerëz me aftësi të kufizuara janë vizituar rregullisht.

## 9,350 pako Krishtlindjeje

Për fëmijët e institucioneve të ndryshme si kopshte, shkolla, spitale, etj. në zonën e Pogradecit, dhe Durrësit u shpërndanë pako Krishtlindjeje nga CHW dhe NEHEMIA.

## 241 persona

44 persona kanë marrë një vakt ushqimi dhe një kafe në mensat tona. 197 fëmijë ushqehen çdo ditë në Qendrën e Përkujdesit Ditor në Durrës dhe në shkollën Amaro Tan.

## 131 bashkëpunëtorë

109 me kohë të plotë, 10 me kohë të pjesshme, 12 të huaj dhe 32 vullnetarë punojnë tek NEHEMIA.

## 18 vjet

Që nga viti 1991 misionarë dhe bashkëpunëtorë të NEHEMIA-s kanë punuar vazhdimisht në Shqipëri.





2009 – Krizë?

Krizë = Mundësi, kështu më ka thënë dikush në fillim të 2009, kur të gjithë të tjerët ishin duke folur për krizë ekonomike apo kriza të tjera. Kjo më kujtoi një thënie të Lothar Späth: “Krizë? – Zonja dhe Zotërinj, kjo është një frymë si në kohë e etheve të arit ... Ah, sikur të isha edhe njëherë në moshën tuaj...”. Dicka ngacmuese për t’u menduar!

Tani në 2010 mund të hedhim vështrimin pas në 2009:

Probleme ekonomike që na rrethojnë, mungesë personeli, ndryshime në personel, një goditje e papritur nga ndryshimi i ligjit mbi taksat, mungesë mirëkuptimi nga zyrat administrative mbi rolin e OJF-ve, përgjegjësi shtesë nga projekti i Shkollës Amaro Tan dhe më pas lajmi trishtues që këshilltari ynë i çmuar, mbështetësi dhe miku ynë, Alfred Wenig, papritur është larguar nga kjo botë. Të gjitha mund të jenë arsye të mjaftueshme për dekurajim dhe dorëheqje.

Megjithatë nuk ndodh aspak kështu, nëse e dimë se kemi miq të vërtetë në Shqipëri dhe jashtë saj, të cilët janë bashkëpunëtorë dhe njerëz të përgjegjshëm, dhe në kohë të vështirë marrin qendrimin “tani më shumë se kurrë”, sepse ata e dinë që ne jemi zëri i atyre që nuk mund të shprehen dot, që nuk kanë zë apo që zëri i tyre nuk dëgjohet: Të varfërit, të sëmurët, fëmijët, të rinjtë, në të ardhmen e të cilëve duam të kemi një impakt – “klientët” tanë. Në këtë rreth janë miq, kolegë dhe njerëz që e ndjejnë përgjegjësinë përpara Perëndisë për këta njerëz që nuk dëgjojnë. Ata e përdorin krizën si një mundësi, sepse aty ata vënë në lëvizje fuqi të veçanta! Pra, ishte e mundur që të ndërmerrim shumë hapa, për të cilat kemi pritur shumë kohë.

Janë hedhur hapa, të cilat na kanë drejtuar në një fazë të re të punës tonë: U krijua një rreth miqsh për të na mbështetur në fushën e edukimit; partneriteti i gjatë me “Kryqin e Misionit të Artë” tashmë është

konkretizuar dhe thelluar; Universiteti ka formuar tashmë profilin e tij në termat e performancës dhe cilësisë si një universitet të vogël dhe ka filluar procesin në 4 janar 2010. Disa nga partnerët tanë për një kohë të gjatë, tashmë janë vetëregjistruar si organizata më vete. Puna e Fondacionit NEHEMIA ka filluar të shtrihet edhe në vende të tjera të rajonit. Ndërtesa dhe ambiente të nevojshme janë përfunduar ose do të përfundojnë më 2010.

Fondacioni NEHEMIA e arriti me sukses fazën delegative si hap i zhvillimit të organizatës. Një hap tjetër si rezultat i mbështetjes së fortë mes të tjerash edhe nga ekonomia dhe politika gjermane, ishte anëtarësimi në DIHA (shoqata e industrisë dhe tregëtisë dhe DAW.

Përmes një aksioni të përbashkët dhe me mbështetjen e përfaqësive gjermane dhe zviceriane, sërish një zë më i fortë u bë e mundur të dëgjohet për organizatat e vogla jofitimprurëse; hapi i parë i suksesshëm drejt kësaj ishte heqja e TVSH-së për arsimin privat në 2010.

Si rrjedhojë, ne shohim që kriza mund të jetë mundësi. Ne dëshirojmë t’i përdorim mundësitë, megjithëse dëshirojmë ta mposhtim krizën. Në të gjitha vendet me të cilat ne punojmë dhe që na mbështesin, të gjithë miqve dhe kishave, nga biznesi dhe politika ne u japim një falenderim të veçantë dhe urojmë një bashkëpunim të mëtejshëm.

Në këtë pikëpamje ne jetojmë me një kurajo inovative, mirënjohje dhe besnikëri ndaj vizionit tonë : **Të duam Perëndinë, Zotin tonë dhe të mësojmë të duam të afërmin si veten tonë.**

*Arnold Geiger*

*Drejtues i Fondacionit NEHEMIA*







## Kisha Alfred Wenig

Të shtunën, 21 shkurt 2009 u organizua shërbesa përkujtimore për të ndjerin Alfred Wenig, një mik besnik dhe një mbështetës i rëndësishëm për NEHEMIA-n në Shqipëri.

Midis shumë projekteve të tjera ai bashkëideoi dhe mbështeti ndërtimin e Qendrës NEHEMIA në Buçimas, ku vëmendja e tij u përqëndrua tek kisha, e cila është qendra dhe zemra e kompleksit.

Kjo është edhe arsyeja pse kjo ndërtesë ka marrë emrin e tij. Një mozaik i bukur me portretin e Alfredit (artist: Anastas Konstandini/Taso) u zbulua në sallonin e kishës, nga arkitekti Helmut Hauser.

Përgjatë përkujtimeve shpresa u duk se triumfoi mbi pikëllimin. Qëllimi i vetëm në jetë i Alfred Wenig ishte t'i shërbente Perëndisë dhe të ndihmonte njerëzit në nevojë. Tani puna e tij e palodhur ka mbërritur në fund dhe ai mund të prehet dhe të korë frutat e një jete në shërbesë ndaj Zotit të gjallë.

Alfredi ishte i njohur gjithashtu edhe si "babai" i organizatës partnere të NEHEMIA-s, "Kryqi i Misionit të Artë" (GKM), e cila mori trashëgiminë për të vazhduar dhe përmbushur punën e tij.

Të dyja organizatat si NEHEMIA edhe GKM do të bashkëpunojnë ngushtë në të ardhmen.

Do të na mungojë këshilla e urtë, eksperiencë e madhe në shumë fusha, ashtu si edhe bekimet dhe lutjet e tij të përditshme.

## Rritimi së bashku: Kisha NEHEMIA dhe Kisha Apostolike

Pas largimit të pastorit tonë të mëparshëm Gian Paul Ardüser dhe familjes së tij, një fazë e re filloi për jetën e kishës.

Unifikimi i kishës NEHEMIA dhe kishës Apostolike erdhi si një zgjidhje e problemit që dy kishat kishin: njëra pa pastor dhe tjetra pa ambiente të mëdha për shërbesat e saj.

Që prej gushtit 2009 janë organizuar shërbesa

të përbashkëta dhe aktivitete të tjera, të pararendura nga shumë vite bashkëpunimi të harmonishëm. Në shkurt 2009 do të merret vendimi përfundimtar mbi unifikimin e dy kishave.

## Bashkimi i Qendrës Lokale Buçimas dhe asaj Pogradec I

Në mënyrë që të rritej efektiviteti i aktiviteteve tona në zonën e Pogradecit, shumica e projekteve janë shpërngulur nga Qendra jonë tradicionale në Pogradec me destinacion Buçimasin, duke krijuar kështu hapësira për përdorim nga Shkolla e Biblës (CfN) dhe Kisha NEHEMIA.

## Rektor i ri për Universitetin NEHEMIA

Ne jemi mirënjohës dhe të nderuar që të kemi një ekspert si Profesor Alexandër von Freyhold, në detyrën e Rektorit të ri të Universitetit NEHEMIA.

Përgjatë karrierës së tij të gjatë ai ka qenë një nga themeluesit e 9 institucioneve të arsimit të lartë, ndërmjet tyre edhe "Universitetin Dual të Mosbah" në Baden-Württemberg, Gjermani dhe programin e parë të studimit, të orientuar drejt praktikës në Universitetin e Durrësit, në Shqipëri.

## Ndërtimet NEHEMIA

Fondacioni NEHEMIA ka përparuar në ndërtimin e ambienteve të reja: ndërtesa e re e shkollës së mesme, që ishte shumë e nevojshme, dhe një shtëpi miqsh e mrekullueshme po marrin formë në kompleksin NEHEMIA.

Punëtorë dhe makineri po punojnë pa pushim që të arrijnë qëllimin amiciz: përfundimi i ndërtesave deri në verën e vitit 2010! Bashkëpunëtorë shqiptarë dhe gjermanë po punojnë së bashku në këtë projekt.

Ndërtesa e re e shkollës së mesme do të përdoret gjithashtu për Universitetin NEHEMIA. Të një rëndësie të veçantë janë gjithashtu edhe arkitektura moderne, teknika ekologjike e ndërtimit dhe pajisjet cilësore të cilat po zbatohen në këtë projekt.



## **Skuadra mike në adidas-NEHEMIA Challenge Cup (a-NCC)**

Për herë të parë skuadra mike nga jashtë vendit morën pjesë në aktivitetin e përvitshëm a-NCC.

Përkrahë skuadrave të shkollave lokale që përfaqësoheshin në futboll, volejboll dhe basketboll, një skuadër nga një shkollë e mesme në Maqedoni dhe një skuadër e adidas-it/Greqi ishin gjithashtu pjesë e këtij turneu; mes këtyre skuadrave u zhvillua një kampionat i vogël miqësor.

Paralelisht u zhvilluan gjithashtu një projekt ndërkulturor ndërmjet shkollës NEHEMIA dhe "Orce Nikolov" në Maqedoni; një punishte ku fëmijët vetë mund të printonin bluzat me grafikën e tyre të preferuar, lojra të ndryshme etj.

## **Partnerë të pavarur**

Me mirënjohje hedhim vështrimin pas tek një partneritet i frytshëm prej 11 vjetësh me MNA e.V. dhe prej 10 vjetësh me CfN. Zyrtarisht rrugët tona u ndanë në 2009, ku të dyja këto organizata u bënë të pavarura.

E njëjta gjë vlen edhe për "Freie Christengemeinde Lörrach e.V." (New Dimensions) në 2010. Sidoqoftë marrëdhënia miqësore në punën tonë për një vizion të madh do të jëtë akoma e njëjtë: **Të duam Perëndinë, Zotin tonë me gjithë zemrën, gjithë shpirtin dhe gjithë mendjen tonë, dhe të mësojmë të duam te afërmin tonë si veten tonë.**

## **Sfida**

### **Largimi i Pastor Gian Paul Ardüser dhe familjes**

Pas një shërbese prej 13 vjetësh si pastor i kishës NEHEMIA, Gian Paul Ardüser dhe familja e tij ndoqën thirrjen e Perëndisë në Gjermani. Pozicioni i tij drejtues nuk na e bënte të lehtë planifikimin se kush do të mund të zinte vendin e tij si pastor.

Ne jemi mirënjohës që Pastor Ardi Shkullaku i kishës Apostolike mori përsipër këtë detyrë.

### **Studentë për Universitetin NEHEMIA**

Që të thuash ishte një sukses që Universiteti NEHEMIA filloi me 8 studentë në 4 janar 2010, tregon që është një sfidë të bindësh studentë potencialë me anë të mundësive tërheqëse, sistemin arsimor dhe prespektivën e Universitetit NEHEMIA në Pogradec.

Vështirësia kryesore për shumë të rinj qëndron në faktin që pozicioni gjeografik i Pogradecit nuk është shumë premtues në krahasim me qytetet e mëdha. Qëllimi i tyre është të studiojnë dhe të sigurojnë një jetesë të rehatshme në një qytet të madh, kryesisht në Tiranë.

### **Ligji për taksat**

Në vitin 2008 ndryshimi në Legjislacionin shqiptar e ngarkoi NEHEMIA-n me një barrë të paparashikuar dhe sfiduese: Organizatat jofitimprurëse duhet të paguajnë 20 % TVSH mbi të ardhurat nga shërbime publike jofitimprurëse.

Ky ligj rëndoi edhe mbi pagesat e shkollave NEHEMIA, duke krijuar një presion të lartë financiar mbi shkollat. Për shkak të reagimit të shumë OJF-ve në Shqipëri, qeveria publikoi një VKM përjashtimi, që shpësojmë të hyjë në fuqi në vitin 2010.



## Vizioni NEHEMIA

“Ta duam Perëndinë me gjithë zemrën, gjithë shpirtin dhe gjithë mendjen tonë dhe të mësojmë të duam të afërmin si veten tonë”

## Misioni NEHEMIA

“Përmes vlerave tona të krishtera do të ndikojmë pozitivisht tek njerëzit dhe tek shoqëritë në Shqipëri dhe në vende të tjera të Ballkanit”

NEHEMIA është e bindur se mënyra më efektive dhe më e qëndrueshme e reformimit të shoqërive është ajo e të ushqyerit të mendjes, trupit dhe frymës së njeriut njëkohësisht. Duke i ndihmuar ata të krijojnë një stil jetese të shëndetshme dhe të bazuar në vlerat biblike, ne transformojmë dhe ndërtojmë jetë dhe kombe.





## Vlerat NEHEMIA

Vlerat themelore të Fondacionit tonë janë:

**Dhembshuria**  
**Falja**  
**Respekti**  
**Integriteti**  
**Ndershmëria**  
**Përkushtimi**

Vlerat dhe parimet tona etike vijnë nga Bibla, që është themeli i punës sonë. Ne besojmë se në këtë libër Perëndia ka dhënë përgjigjet dhe zgjidhjet e Tij për problemet e shumta përmes së cilave po kalon shoqëria jonë në ditët e sotme.

Në këtë pikëpamje është thelbësore që drejtuesit dhe bashkëpunëtorët tanë të respektojnë dhe të veprojnë sipas vlerave dhe standardeve të Fondacionit tonë dhe që këto vlera të bëhen pjesë e punës së tyre.

### Ballkan







## Qendrat Kombëtare

**Shqipëri** (*Buçimas*)  
NC AL

**Universiteti NEHEMIA** (*Buçimas*)  
NC NU

## Qendrat Lokale

**Buçimas**  
LC PG BC

**Durrës**  
LC DR

**Has**  
LC HS

**Peshkëpi**  
LC PG PE

**Gjirokastrë**  
LC GJ

**Amaro Tan**  
LC PG II

**Bishnicë**  
LC PG BI

## Partnerët

**Kisha Apostolike**  
ACH

**Organizata e Krishterë  
Humanitare, Wismar**  
CHW

**Global Business Assist**  
(Mision bashkëpunimi në SHBA)  
GBA

**Misioni i Kryqit të Artë**  
GKM





## Qendrat Kombëtare - Lokale

Shqipëri (NC AL) dhe Buçimas (LC PG BC)  
Qendra Kombëtare dhe Lokale e Fondacionit NEHEMIA, në Buçimas pranë Liqenit të Ohrit, përbëhet nga 8 ndërtesa (dy nën ndërtim), të cilat janë multifunkionale. Në këtë qendër ndodhet administrata, shkolla NEHEMIA, kisha dhe universiteti.

Universiteti NEHEMIA (NC NU)  
Në 4 Janar 2010 Universiteti NEHEMIA nisi procesin akademik me degët Bachelor of Arts në Biznes dhe Ekonomi dhe së shpejti me Master në Studime Evropiane. Universiteti ndodhet në Qendrën Kombëtare NEHEMIA, në Buçimas.

Durrës (LC DR )  
Në këtë qytet në brigjet e Adriatikut, NEHEMIA kujdeset kryesisht për komunitetin rom dhe për familje të varfëra në zonën përreth. Përkrah aktiviteteve të ndryshme frymërore, jepet ndihmë humanitare dhe është krijuar një Qendër e Kujdesit Ditor për fëmijët.

Gjirokastrë (LC GJ)  
Në këtë qytet në jug të Shqipërisë, ndodhet një tjetër qendër e NEHEMIA-s. Kjo qendër shërben nëpërmjet shërbesave frymërore dhe ndihmës sociale, siç janë një mensë, qendër e kujdesit ditor dhe vizita në shtëpi.

Has (LC HS)  
Në qytetin e Krumës, në Has ndodhet një tjetër qendër, në të cilën bashkëpunëtorët tanë shërbejnë me një dhomë fizioterapie, një zyrë këshillimi dhe projekte të ndryshme për zhvillim komuniteti.

Amaro Tan (LC PG II)  
Shkolla Amaro Tan është një institucion privat Protestant që ofron edukim dhe përkujdesje për fëmijët. Kjo shkollë e vendosur në periferi të qytetit të Pogradecit trajton kryesisht fëmijë të komunitetit rom dhe me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike.

Bishnica (LC PG BI)  
Në këtë fshat të thellë malor, gati tre orë më makinë nga Pogradeci, partneri i NEHEMIA-s, CHW, shërben prej shumë kohësh me shërbesa frymërore, ndihmë sociale dhe mjekësore si dhe një fjetore për fëmijët e fshatrave të thella të zonës.

Peshkëpi (LC PG PE)  
Përmes projektit për zhvillim komuniteti, NEHEMIA ka ndihmuar në fshatin Peshkëpi që prej vitit 2000. Projekte të ndryshme humanitare dhe ndërtimi janë aplikuar në këtë zonë në bashkëpunim të ngushtë me GKM, një nga partnerët tanë.


## Partnerët

Kryqi i Misionit të Artë (GKM)  
GKM punon ngushtë me NEHEMIA-n duke mbështetur projektin për zhvillim komuniteti në Peshkëpi dhe projekte të ndryshme ndërtimi. Bashkëpunimi është bërë shumë i ngushtë dhe së shpejti do të krijohet një strukturë e re me qëllim ngritjen e një rrjeti ndërkombëtar shërbimesh.

Kisha Apostolike (ACH)  
Kisha Apostolike shërben tek njerëzit në zonat përreth Pogradecit, kryesisht me anë të projekteve shpirtërore por edhe me ndihma humanitare dhe sociale. Në 2009 në fshatin Stropckë u inagurua ndërtesa e re e kishës Apostolike.

Organizata e Krishterë Humanitare Wismar (CHW)  
CHW e ka strukturuar punën e saj në zonën e Mokrës në Pogradec, sipas një Qendre Lokale NEHEMIA duke shërbyer me aktivitete frymërore, sociale dhe arsimore.

Global Business Assist  
*Misioni bashkëpunues (GBA)*  
NEHEMIA bashkëpunon me organizatën amerikane për zhvillimin e biznesit, GBA. Ata na kanë mbështetur vazhdimisht në plotësimin e projekteve të ndryshme mbi edukimin dhe biznesin.





## Qëllimi i strukturës së një Qend- dre Lokale, Kombëtare dhe Rajonale

Zhvillimi i Qendrave të ndryshme NEHEMIA në Shqipëri me fusha shërbimesh frymërore, sociale, mjekësore dhe edukimi, është një pjesë thelbësore e strukturës NEHEMIA.

Aktualisht Qendrat Lokale gjenden në Buçimas, Durrës, Gjirokastrë, Has, Pogradec (2x), Bishnicë dhe Peshkëpi.

Dy Qendrat Kombëtare, Shqipëri dhe Universiteti (vendndodhja Buçimas) koordinojnë punën ndërmjet Qendrave Lokale.

Një Qendër Rajonale është baza për një impakt dhe rritje në rajonin e Evropës Juglindore.

## Bordi Mbikqyrës (SuBo)

Kai Uellendahl (Vorsitzender)  
Christian Vögeli  
Fabiola Haxhillari  
Helmut Hauser  
Frieder Weinhold

## Bordi Ekzekutiv (ExBo) dhe i Univer- sitetit NEHEMIA (NuBo)

Arnold Geiger  
Isolde Flessa  
Herolinda Shkullaku  
Alexander von Freyhold  
Alma Vögeli  
Barbara von Schnurbein  
Toni Gogu  
Rob Provost

## Bashkëpunëtore (131 gjithsej)

109	Shqiptarë (me kohë të plotë)
10	Shqiptarë (me kohë të pjesshme)
12	Të huaj
32	Vullnetarë



**Fokusi**  
 kryesor i NEHEMIA-s janë tre fushat e shërbimit Kisha, Puna Sociale dhe Mjekësore dhe Edukimi. Gjithashtu administrim i mirë i Burimeve Njerëzore, Operative dhe Komunikimit.

**Puna Sociale dhe Mjekësore:**  
 të shërbejmë nëpërmjet ndihmës sociale dhe mjekësore

**Drejtimi i Qendrës Lokale**


Të drejtojë qendrën dhe të orientojë projektet sipas Vizionit dhe Misionit NEHEMIA

**Edukimi**

Të ofrojmë arsimim dhe kualifikim.

**Kisha**

Të mbjellim dhe të rrisim bashkësi të krishtera vetëshumëfishuese e të qëndrueshme në Shqipëri dhe në të gjithë rajonin e Ballkanit




**Komunikimi dhe Marrëdhëniet**

Informacioni dhe komunikimi profesional parandalojnë thashethemet.

**Burimet Njerëzore dhe Operative**

Sfidat janë pozitive dhe na bëjnë më të mirë. Parimi ynë është: nëpërmjet sfidave nxisim dhe nxjerrim në pah aftësitë dhe potencialin e punonjësve.

**Struktura e një Qendre Lokale NEHEMIA**



*“Strukturat janë në funksion të strategjisë dhe të të shërbyerit.”*





## Shërbesa frymërore

Kisha NEHEMIA bën pjesë në lëvizjen ndërkombëtare Pentakostale dhe Vëllazërinë Ungjillore, në Shqipëri. Ajo është kishë Ungjillore dhe doktrina e saj është bazuar në Bibël. Puna frymërore është themeli i të gjitha aktiviteteve tona dhe vlerat NEHEMIA vijnë nga Bibla. Ne besojmë se në këtë libër Zoti na ka dhënë të gjitha përgjigjet dhe zgjidhjet për problemet që shoqëria po kalon sot.

Kisha lokale luan një rol thelbësor në shërbesat tona frymërore. Në këto shërbesa futen ungjillizimet, qelizat, takime lutjesh, takime inkurajuese dhe sociale për të varfërit dhe personat me probleme sociale.

### Shërbesat e Kishës

Kisha NEHEMIA zhvillon shërbesa në tre qytete (Pogradec, Durrës dhe Gjirokastër) dhe në 11 fshatra përreth këtyre qyteteve. 217 të rritur dhe 323 fëmijë marrin pjesë në këto shërbesa.

Gjithashtu partnerët tanë ACH dhe CHW vazhdojnë shërbesat e tyre frymërore në Pogradec dhe disa fshatra përreth.

Shërbesa për fëmijë, të rinj, gra dhe burra zhvillohen gjithashtu përgjate gjithë vitit duke mbështetur projektet në fushën sociale dhe të edukimit.

### Takime frymërore

Një shumëllojshmëri njerëzish takohen për një rritje shpirtërore në qendrat NEHEMIA, në takimet për fëmijët, grupit të të rinjve, grave, burrave apo qelizat.

Aktivitete si leximi i Biblës, adhurim, lutje, organizimi i mbrëmjeve kreative, lojra apo projekte të ndryshme, janë tipike për këtë takim.

### Takime për fëmijë

Si pjesë e jetës shkollore në shkollën dhe kopshtin Amaro Tan ofrohet kohë meditimi për 137 fëmijë çdo ditë. Gjithashtu organizohen takime të ngjashme në shkollën NEHEMIA me pjesëmarrjen vullnetare të 165 fëmijëve. Takime të rregullta organizohen edhe në qendrat e tjera





NEHEMIA, përgjatë shërbesave të së dielës në kishë ose në qendrat e partnerëve tanë CHW dhe Kisha Apostolike me programin përkatës.

Skautistët e Krishterë "Royal Rangers" takohen gjithashtu dy herë në muaj në Buçimas.

### Takimet e grave

Përgjatë 2009-s janë zhvilluar disa takime për gra në Buçimas ku kanë marrë pjesë rreth 10-15 gra. Gjithashtu nëna dhe kliente të punës sociale kanë qenë të ftuara në këto takime.

### Qelizat dhe takimet e lutjes

Këto takime janë një pjesë shumë e rëndësishme e kishës dhe si palestër për besimin dhe marrëdhënien me Zotin dhe komunitetin. Këto qeliza zhvillohen në disa qendra NEHEMIA.

### Kampe verore për fëmijë dhe të rinj

Si çdo vit Kisha NEHEMIA organizon kampe të ndryshme verore. Edhe për këtë vit u organizuan:

- Kampi veror për fëmijë me 55 pjesëmarrës, Durrës
- Kampi veror për vajza me 20 pjesëmarrës, Durrës
- Kampi veror për fëmijë me 50 pjesëmarrës, Pogradec
- Kampi Royal Rangers me 50 pjesëmarrës, Buçimas
- Kampi veror për fëmijë me 70 pjesëmarrës, Gjirokastrë
- Kampi veror për 6 familje, Gjirokastrë

### Seminare

- Uniteti si bekim në skuadër. *Kisha NEHEMIA (Durrës)*
- Marrëdhëniet në martesë, familje dhe komunitet. *Walter Rückstei (Zvicër)*
- Adhurimi, *Kisha NEHEMIA (Durrës)*
- Shërbesat lokale dhe universale në Kishë, *Kisha Apostolike, Sandro Sardella (Itali)*
- Uniteti i Kishës, *Kisha Apostolike, Andrea Thomas (Itali)*

### Fakte

**217** të rritur dhe **323** fëmijë marin pjesë rregullisht në kishat NEHEMIA.

**165** nxënës të shkollës NEHEMIA marrin pjesë vullnetarisht në takimet e fëmijëve.

**Çdo ditë** kalohet kohë meditimi për 137 nxënës të shkollës Amaro Tan.

### Fakte

**Disa grupe dhe njerëz takohen për takime frymërore për:**

Fëmijë, grupe të rinjsh, gra, burra dhe qeliza.

**Aktivitete:**

Studim Bible, adhurim, lutje, mbrëmje kreative, lojëra, projekte, ekskursione etj.

### Synimi NEHEMIA Nr.1:

"Të mbjellim dhe të rrisim bashkësi të krishtera vetëshumëfishuese e të qëndrueshme në Shqipëri dhe në gjithë rajonin e Ballkanit"



### **Fakte - shërbesa frymërore**

**6** kampe të ndryshme u organizuan për fëmijët.

**5** seminare të ndryshme u organizuan në 2009.

**50** persona morën pjesë në kampin Royal Rangers i organizuar për herë të parë nga drejtues shqiptarë.

### **Aktivitete të tjera**

Viti 2009 ka qenë një vit i mbushur me aktivitete të ndryshme në Buçimas, Stropckë, Pogradec, Durrës and Gjirokastrë:

- Shfaqje muzikore “Tre Mbretërit” e organizuar nga nxënësit e shkollës NEHEMIA në Pogradec, Buçimas, Peshkëpi dhe Gjirokastrë.
- Inagurimi i ndërtesës së re të Kishës Apostolike në Stropckë.
- Takim burrash në Gjirokastrë me 12 pjesëmarrës.
- Mbrëmje kreative në Buçimas, me lutje, adhurim dhe dekorime për festat e fundvitit.
- Organizimi i një kursi edukativ 4-mujor për fëmijët nga kisha NEHEMIA në Gjirokastrë.

### **Royal Rangers**

50 të rritur dhe fëmijë nga Buçimasi, Durrësi dhe Elbasani morën pjesë në kampin e Royal Rangers 2009, i organizuar për herë të parë nga drejtues shqiptarë.

Gjithashtu 10 të rinj së bashku me drejtuesin e tyre nga Maqedonia ishin të ftuar në këtë kamp.

Kampi u zhvillua afër liqenit të Ohrit, duke u dhënë në kështu të gjithëve mundësinë për të eksploruar natyrën dhe sekretet e saj.

Uniteti dhe bashkësia ishin tema e këtij kampi, duke u sjellë në jetë nga bashkëpunimi i shkëlqyer ndërmjet drejtuesve. Në fund të gjithë u larguan me përshtypje shumë të mira dhe me premtimin që të jenë pjesë e tij vitin që vjen.

Puna e Royal Rangers në Shqipëri vazhdon me qendër në Buçimas. Në Durrës një postë e dytë është planifikuar të fillojë në 2010.

Në nivel ndërkombëtar, organizata e Skautistëve të Krishterë e përfaqësuar në 73 vende të botës, synon të instruktojë, sfidojë dhe frymëzojë fëmijët dhe të rinjtë në fushën e njohurive biblike, shërbesës së krishterë dhe udhëheqje shpirtërore.









## Ndihma Sociale dhe Mjekësore

Njeriu i vogël që bën pjesë në logon NEHEMIA simbolizon gjithë filozofinë e tij: **Kryqi që u bë njeri**. Disa nga projektet e kanë kthyer këtë koncept në praktikë, duke sjellë ndihmë dhe mbështetje për qindra njerëz në nevojë.

Shërbimet që projekti social dhe mjekësor kryen janë të shumta si: vizita në shtëpi, ndihmë për individë dhe institucione, ndihma materiale dhe ekonomike për familje, shërbime mjekësore, fizioterapi në shtëpi apo në klinikën NEHEMIA, zhvillim komuniteti etj.

### Vizitat në shtëpi

Vizitat në shtëpi janë një pjesë shumë e rëndësishme e projektit të mirëqenies, duke ofruar ndihmë tek një numër në rritje të nevojtarëve, veçanërisht mosha e tretë dhe personat me aftësi të kufizuara.

Përgjatë vitit 2009 janë kryer gjithsej 3,856 vizita në 101 familje dhe individë në Pogradec, Gjirokastrë dhe fshatrat përreth.

Këto vizita konsistojnë në:

- këshillim dhe inkurajim, ndarje e ungjillit, leximi i Biblës, lutje etj.
- ndihmë për pastrim dhe higjenë personale
- trajnim i pjesëtarëve të familjes se si të kujdesen për të sëmurin apo personin me aftësi të kufizuara.
- vizita mjekësore falas (kontrolli herë pas here nga mjekë të huaj dhe shqiptarë).


- fizioterapi dhe masazh, terapi loje dhe ergoterapi në dhomat e fizioterapisë dhe pedagogjisë, por edhe shërbim në shtëpi.
- mësim mbi gatimin, planifikimin familjar etj.

### Ndihmë për individë dhe familje

NEHEMIA ka ndihmuar gjithmonë individë dhe familje të ndryshme me ndihma materiale dhe financiare. Përgjatë vitit 2009 janë ndihmuar 119 familje dhe 403 individë me ndihma të ndryshme si: ushqime, veshmbathje, mobilje, financa etj.

9 të rritur dhe 15 fëmijë janë ndihmuar me blerjen e medikamenteve të ndryshme.

CHW një nga partnerët tanë ka kontribuar gjithashtu me ndihma sociale dhe mjekësore në zonën e Mokrës.



### Fakt - ndihmë sociale

3.856 vizita në 101 familje dhe individë.



## Mensa

Të kesh një vakt të ngrohtë për të ngrënë dhe një kafe për shumë prej nesh është diçka normale, por për shumë të tjerë është një sfidë ditore.

Kjo është arsyeja që që prej vitit 1992 NEHEMIA ka hapur mensat në Pogradec, Gjirokastër dhe Peshkëpi, ku këta persona mund të marrin një pjatë të ngrohtë ushqim dhe një kafe, çdo ditë. Gjithashtu të bisedojnë dhe të kalojnë kohë me njëri-tjetrin dhe me bashkëpunëtorët e NEHEMIA-s.

Gjatë vitit 2009 u janë shërbyer 44 personave në mensat tona. Gjithashtu rreth 197 fëmijë në Qendrën e Kujdesit Ditor në Durrës dhe në shkollën Amaro Tan, në Pogradec marrin çdo ditë ushqim të ngrohtë falas.

## Qendrat e përkujdesit ditor

Fëmijët e komunitetit rom diskriminohen në shkollat publike ku ata shkojnë, për këtë arsye mbështetja që ata marrin në këto qendra është shumë e rëndësishme për jetën e tyre.

Fondacioni NEHEMIA, Durrës prej disa vitesh ka hapur dhe drejton një Qendër të Përkujdesit Ditor për fëmijët e komunitetit rom, në fshatin Nishtullë. Janë 60 fëmijë të cilët ndihmohen çdo ditë me përgatitjen e detyrave të shkollës dhe me një vakt ushqimi.

Gjithashtu një program prej 30 minutash është krijuar për të gjithë fëmijët ku së bashku bëjnë lavdërim, adhurim, njohje me Perëndinë, historitë nga Bibla, lojëra etj.

Fëmijët në këtë qendër marrin gjithashtu falas ndihma materiale dhe shkollore.

Një qendër e njëjtë do të krijohet edhe në Gjirokastër, me fokusin tek fëmijët e komunitetit rom. Ata do të ndihmohen çdo ditë me përgatitjen e detyrave të shkollës, ndihma sociale dhe një vakt ushqimi, si dhe aktivitete zbavitëse.

## Fjetore dhe Strehë

CHW, organizata jonë partnere ofron një fjetore në fshatin Bishincë, që ndodhet 3 orë me makinë larg Pogradecit, për 5 nxënësit që banojnë në fshatrat e zonave të thella malore. Për shkak të pozitës së vështirë gjeografike, ata duhet të bëjnë disa orë rrugë në këmbë për të shkuar në shkollën më të afërt. Në këtë konvikt fëmijët ndihmohen edhe në detyrat e shtëpisë si dhe marrin pjesë në një kurs për gjuhën angleze, një herë në javë.

Një program strehimi ekziston në Bishnicë dhe Pogradec. Partneri ynë CHW siguron strehë për dy persona në fshatin Velçan, ndërkohë që në Pogradec dy persona të tjerë kanë një strehë për të jetuar falas dhe marrin mbështetje të vazhdueshme nga projekti social.



### Fakt - ndihmë sociale

241 pesonave u është shërbyer një vakt i ngrohtë çdo ditë = 72300 vakt/vit.



## Synimi NEHEMIA Nr.2:

“Të shërbejmë nëpërmjet ndihmës sociale dhe mjekësore.”

### Fizioterapi dhe ndihmë mjekësore

Dhoma e fizioterapisë në Krumë/Has dhe dhoma e terapisë në Buçimas/Pogradec janë pjesë shumë e rëndësishme. Trajtimi i fizioterapisë i krijuar në Krumë që prej vitit 2005 u shërben njerëzve me probleme në aparatit e lëvizjes. Ky është i vetmi shërbim i këtij lloji në të gjithë zonën e Shqipërisë veriore.

Përgjatë vitit 2009 janë trajtuar 130 pacientë, nga të cilët 15 janë të rregullt në trajtimin e tyre për një periudhë të gjatë. Për të gjithë pacientet shërbimi është falas.

Në dhomën terapeutike në Buçimas janë trajtuar rregullisht 10 fëmijë. Tashmë janë 2 dhoma që shërbejnë për trajtim dhe shpresojmë që numri i pacientëve që mund t’ju shërbejmë të rritet. Shërbimi mjekësor që ofrohet është fizioterapi dhe pedagogji zhvillimi njëkohësisht.

Gjatë vitit 2009 janë shoqëruar 6 fëmijë në Qendrën e Kujdesit të Zhvillimit dhe Rehabilitimit në Tiranë.

### Fakt - ndihmë mjekësore

**505** pacientë janë trajtuar në Klinikën NEHEMIA përgjatë 2009.

### Klinika NEHEMIA

Në 7 korrik 2006 u miratua rinovimi i licensës nga Ministria e Shëndetësisë për klinikën NEHEMIA, në Buçimas, ku shumica e klientëve të projektit social dhe nxënësit e shkollave NEHEMIA marrin shërbim.

Gjithashtu seminare dhe trajnime organizohen nga ekipi ynë mjekësor për:

- Nxënësit e shkollave dhe studentët e Universitetit NEHEMIA
- Prindër të Shkollës Amaro Tan
- Komunitetin

Gjate vitit 2009 janë trajtuar rreth 505 pacientë nga ekipi ynë mjekësor : 1 mjek, 2 infermiere, njëra nga të cilat ishte gjermane dhe shërbeu për 6 muaj vullnetarisht.

Gjithashtu u ofrua edhe ndihmë praktike për klinikën e organizatës sonë bashkëpunuese SFI në Spille/Durrës për rreth tre javë.

### Seminare

- “Pediatria, sëmundjet infektive si dhe trajtimi i tyre nga mjekët dhe në kushtet e shtëpisë” (*Katerina Mamzorida, Greqi*)
- “Personat me aftësi të kufizuara mendore, kriteret e cilësisë në punën sociale, dhe çrregullimi dëgjimor” (*Rene Biela, Gjermani*)
- “Të ushqyerit dhe shëndeti i njeriut” (*Eberhard Brachtel, Gjermani*)





## Zhvillim komuniteti dhe Ndhmë për Institucionet

Gjatë vitit 2009 janë dhënë ndihma për komuna dhe disa institucione të ndryshme:

- Restaurimi i Shtëpisë së Kulturës në Peshkëpi, ku përgjatë vitit u organizuan shumë aktivitete kulturore.
- Restaurimi i kopshtit publik në fshatin Vërdovë në bashkëpunim me Ambasadën Gjermane dhe Komunën Buçimas.
- Dhurim automjeti për pastrimin e plehrave në Komunën Buçimas.
- Dhurim materialesh mjekimi për spitalin e qytetit të Pogradecit.
- Materiale didaktike për fëmijët në një zonë të Durrësit.
- Heqja e plehrave dhe punësimi i dy punëtorëve në fshatin Peshkëpi.
- Mjete didaktike, lodra, tapete etj. për kopshtet publike në Vranisht dhe Krumë/Has.

## adidas-NEHEMIA Challenge Cup 2009

Ky është viti i tretë në të cilin Adi Dassler Fund (adidas) dhe Fondacioni NEHEMIA kanë organizuar aktivitetin sportiv "adidas-NEHEMIA Challenge Cup". Finalet u organizuan në muaji tetor, në kuadër të Tetorit Gjerman, në kompleksin e Fondacionit NEHEMIA në Buçimas.

32 shkolla nga rrethi i Pogradecit ishin të ftuara në këtë aktivitet, i cili u zhvillua në bazë të një marrëveshjeje ekzistuese midis Zyrës Arsi-

more, Njësite të Qeverisjes Lokale dhe Fondacionit NEHEMIA.

Faza gjysëm finale u zhvillua nëpër komuna sipas sitemit 9-vjeçar, ndërsa finalet u zhvilluan në kompleksin NEHEMIA, ku 340 fëmijë u akomoduan për tre ditë. Rreth 1400 fëmijë morën pjesë në të gjithë aktivitetin.

Vlera si drejtësia, ndershmëria dhe loja në skuadër ishin në fokus përgjatë gjithë kampionatit.

Si kriter kualifikimi për finalet, çdo shkollë organizoi një projekt social ose në ndihmë të komunitetit, i cili u prezantua paralelisht me kampionatin. Fituesit morën nga një çmim special.

Paralelisht me Kupën një kampionat miqësor u zhvillua ndërmejt skuadrave mike nga Gjirokastra, Hasi, Durrësi, Maqedonia dhe Greqia.

Përgjatë vitit, disa skuadrave iu dhuruan pajisje sportive, topa, rrjeta volejboli, dhe në disa raste ndihma financiare për rinovimin e këndeve sportive.

### Fakte - adidas-NEHEMIA Challenge Cup

**1400** fëmijë morën pjesë në aktivitet.

**5** skuadra mike nga Gjirokastra, Durrësi, Hasi, Maqedonia dhe Greqia.

**32** shkolla morën pjesë në këtë kampionat.







## Fakte

**68** fëmijë ndjekin kopshtet NEHEMIA dhe Amaro Tan.

Kopshti NEHEMIA kishte vetëm **12** fëmijë në filimet e tij; tani numërohen **32** fëmijë.

Kopshti Amaro Tan numëron **36** fëmijë.





## Edukimi NEHEMIA

Ndryshimet e qëndrueshme në shoqëri mund të arrihen vetëm nga një numër në rritje njerëzish të mirëarsimuar dhe të kualifikuar, që do të kenë ndikim në mjedisin dhe shoqërinë e tyre.

Fokusi kryesor në edukim është brezi i ri, që nga niveli i kopshtit deri në nivel universitar, duke përfshirë këtu edhe kualifikimin profesional.

### Kopshtet NEHEMIA

Kopshtet NEHEMIA ofrojnë bazë materiale didaktike të plotë, transport të sigurtë, ushqim si dhe ambiente komode. Fëmijët marrin një edukim cilësor dhe një përkujdesje të madhe nga edukatorët e kualifikuar.

Në veprimtarinë e tij kopshti synon:

- Të zhvillojë personalitetin e fëmijës parashkollor dhe ta përgatisë atë për arsimim të mëtejshëm.
- Të edukojë fëmijën me cilësitë e duhura që e bëjnë atë të aftë për bashkëpunim me të tjerët.
- Të zhvillojë personalitetin e fëmijeve sipas vlerave të Fondacionit NEHEMIA.
- Të zgjerojë përvojën, njohjen, aftësitë ndijore, aftësitë për të vepruar, folur, menduar dhe imagjinuar nëpërmjet ushtrimeve të përcaktuara për secilin fëmijë.
- Të edukojë fëmijën përtë qënë i përgjegjshëm në pëdorimin e mjeteve të përbashkëta.

### Kopshti NEHEMIA

Fillimisht, në 1992, kopshti NEHEMIA ka pasur vetëm 12 fëmijë, tani ai numëron 32 fëmijë.

Puna edukative është organizuar sipas planit vjetor të hartuar në bazë të programit të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Gjuha angleze është pjesë e programit ditor, si edhe gjuha shqipe.

Gjithashtu kopshti NEHEMIA organizon aktivitete argëtuese në bashkëpunim me mësuesit, prindërit dhe fëmijët.

Një komunikimi transparent dhe i hapur me prindërit kryhet çdo ditë.

### Kopshti Amaro Tan

Kopshti Amaro Tan numëron 36 fëmijë kryesisht nga komuniteti rom dhe familje të varfëra.

Programi që ndiqet në kopshtin Amaro Tan është i miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës me disa elemente shtesë si një kurrikul e krishterë dhe elementë Montessori. Amaro Tan është i regjistruar si një institucion Protestant privat.

Fëmijët inkurajohen që të zhvillojnë projekte sociale, aktivitete zbavitëse, zbulojnë dhe zhvillojnë talentet e tyre në muzikë, këngë, pikturë, aktrim, rrobaqepësi etj.

Kopshti është i pajisur me bazë materiale të nevojshme dhe ambiente të këndshme.

## Synimi NEHEMIA Nr.3

“Të ofrojmë edukim dhe kualifikim”



## Fakte

**290** nxënës ndjekin shkollën NEHEMIA.

**15** nxënës kanë fituar në olimpada në nivel rrethi dhe kombëtar.

Në shkollën Amaro Tan janë regjistruar **101** nxënës nga klasa e parë deri në të nëntën.

## Shkollat NEHEMIA

Të dyja shkollat janë të pajisura me bazë materiale didaktike, laboratorë fizike, kimie dhe informatike, në këtë mënyrë nxënësit kanë mundësi të praktikojnë njohuritë e tyre.

Shkollat janë të pajisura gjithashtu me kënd sportiv cilësor, transport të sigurtë, ushqim cilësor dhe ambiente komode.

## Shkolla NEHEMIA

Ka filluar veprimtarinë e saj në vitin 1998 me pesë klasa, ndërsa sot ajo e ka shtrirë veprimtarinë saj deri në gjimnaz dhe në të studiojnë 290 nxënës.

Shkolla në veprimtarinë e saj synon:

- Arsimimin dhe edukimin cilësor të nxënësve
- Zhvillim e personalitetit të nxënësve sipas vlerave të Fondacionit NEHEMIA.
- Nxitjen dhe mbështetjen e mendimit krijues, tolerant, të pavarur dhe kritik.
- Përgatitjen për një arsimim të mëtejshëm në Universitetin NEHEMIA.

Programi shkollor është i njëjtë me programin e shkollave publike, por ka edhe disa programe shtesë si:

- Gjuha angleze fillon në klasë e parë.
- Gjuha gjermane fillon në klasë e tretë.
- Informatika fillon në klasën e pestë (*mësimet kryhen në grupe*)
- Zhvillohen gjithashtu aktivitete të tjera jashtë shkollore si pikturë, piano, drama dhe aktivitete sportive.

Nxënësit e klasës së parë këtë vit iu nënshtruan një konkursi dhe një testi inteligjence nga një psikolog gjerman.

Shkolla NEHEMIA inkurajon dhuntitë e nxënësve të talentuar dhe kjo ka sjellë që gjatë vitit shkollor nxënës të kësaj shkolle të bëhen fitues në olimpada të ndryshme që zhvillohen në nivel







rrethi apo kombëtar.

Partneritet me shkolla të huaja:

- Shkolla „Stiftung Landheim Schondorf am Ammersee“ Gjermani, ku 2 nxënësit më të mirë marrin një ftesë për të kryer 3 muaj mësim në këtë shkollë. Shkolla Schondorf është anëtare e Round Square School që prej 2008-s, kështu është e mundur që të përfshihemi në projekte partneriteti.
- Shkolla “Orce Nikolov High School” në Maqedonia. Projekte të ndryshme për shkëmbim eksperiencash kulturore janë zhvilluar suksesshëm përgjatë 2008/2009, të financuara nga BE.

### Shkolla Amaro

Shkolla Amaro Tan është e fokusuar kryesisht në integrimin e fëmijëve të komunitetit rom dhe familjeve të varfëra.

Shkolla është një vend strehimi për fëmijët, duke i shpëtuar ata nga trafikimi, abuzimi dhe shumë probleme sociale.

Amaro Tan është e regjistruar si Institucion Protestant privat dhe synon më shumë se një edukim të thjeshtë. Në gjuhën romë “Amaro Tan” do të thotë “Vendi Ynë” dhe në të vërtetë shumë fëmijë ndihen si në shtëpinë e tyre.

Progami i edukimit në Amaro Tan është i aprovuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës me disa elementë shtesë si: kohë meditimi, elementë Montessori, programet sociale dhe frymërore, të cilat janë zhvilluar në mënyrë të tillë që t'i shërbejnë fëmijëve dhe familjeve të tyre.

- **Programi i dusheve.** Larja në dushe kryhet nën vëzhgimin e dy të rriturve. 20 fëmijë marrin pjesë dy herë në javë në këtë program higjence.
- **Zhvillim talentesh.** Nxënësit këtu kanë

mundësinë të zhvillojnë talentet e tyre në muzikë, këngë, pikturë, aktrim etj.

- **Kursi i rrobaqepësisë.** 20 vajza nga klasa e tretë deri tek ajo e teta marrin pjesë në këtë kurs. Dy herë në javë, ato kanë mundësinë që të praktikojnë njohuritë e tyre për 1 orë.
- **Koha e meditimit.** Të gjithë nxënësit marrin pjesë në këtë kohë, e cila zhvillohet çdo mëngjes nëpër klasat e tyre. E gjithë kurrikula e kopshtit flet për tema frymërore, ndërkohë që klasat nga e I deri në të IX kanë lëndë specifike që reflektojnë mbi prespektivën biblike.

### Shkolla e Mesme me kohë të reduktuar

Shkolla e mesme me kohë të reduktuar zhvillohet në Qendrën NEHEMIA, në Buçimas. Kjo shkollë i jep këtyre të rinjve një shans të dytë për një arsim të kualifikuar. Për shumë nga këta të rinj është e vështirë që të marrin një arsimim të kualifikuar gjatë ditës. Katër nxënës frekuentojnë këtë shkollë.

### Edukimi profesional

- 2 kurse parukerie
- 1 kur rrobaqepësie
- 1 kurs i gjuhës angleze
- 1 kurs i gjuhës gjermane

37 persona u kualifikuan në këto kurse të aprovuara nga shteti në 2009.





## Universiteti NEHEMIA

Viti 2009 u shfrytëzua për përgatitje të mëtjshme, me qëllimin që viti akademik të fillojë në 4 janar 2010.

Për nga aspekti akademik, administrativ dhe infrastrukturor, çdo gjë u përgatit për të garantuar një program akademik sipas standardeve të Evropës Perëndimore.

### Sfidat

Sidoqoftë, pengesa të paparashikueshme duhen kapërcyer: numri i të rinjve që përmbushën kriteret e një aplikimi të nevojshëm për pranimin në universitet ishte i vogël.

Programi dual i studimit kërkon përkushtim dhe disiplinë, të cilat janë kritere që rrallë i gjen në sistemin e arsimit të lartë në Shqipëri. Një pengesë tjetër ishte edhe pozicioni gjeografik i Universitetit NEHEMIA, në qytetin e vogël të Pogradecit, shumë larg kryeqytetit për shijet e shumicës të të rinjve.

Së fundmi, vonesa në dhënien e lejes për fillimin e aktivitetit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës brenda afatit ligjor tregoi edhe njëherë një pengesë tjetër në rrugën drejt një funksionimi normal të universitetit.

Në 4 janar 2010 grupi i parë i përbërë nga studentë ambiciozë dhe të talentuar, shumica ish-nxënës të shkollës NEHEMIA, filluan udhëtimin e një edukimi të lartë tek NEHEMIA.

### Aktivitete në 2009

Një nga të veçantat është edhe emërimi i Rektorit të ri, Profesorit Gjerman Alexander v. Freyhold.

Si një nga iniciatorët e shumë universiteteve në Gjermani dhe të programit dual në Shqipëri, ai ka një eksperiencë të madhe në ndërtimin e projekteve ambicioze nga themelet dhe në zhvillimin e tyre në një institucion prestigjioz dhe të plotë të edukimit të lartë.

Përgjatë 2009 ne kemi standardizuar dhe përmirësuar kurrikulat dhe dokumentacionin e nevojshëm për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencave. Gjithashtu kemi investuar në infrastrukturë dhe teknologji, duke krijuar kështu ambiente komode për seminare, studim dhe leksione.

Një numër i konsiderueshëm mbështetësish nga e gjithë bota janë gati për të kontribuar njohuritë dhe ekspertizën e tyre. Organizata e sapokrijuar "Miq të NEHEMIA-s" në Welheim/Gjermani koordinon dhe promovon punën e bërë.

*Performancë. Cilësi.*





## Programi

### Bachelor në Biznes dhe Ekonomi

“Programi Dual” ndjek një koncept jo shumë të njohur në Shqipëri: kombinimin e studimeve akademike me praktikë të aplikuar në një kompani apo biznes.

Kompanitë dhe bizneset në zonë kanë treguar një interes në rritje mbi këtë koncept të ri dhe me prespektivën për të trajnuar administratorët e tyre të ardhshëm brenda në Shqipëri.

**Studime të kombinuara: Master për Studime Evropiane (Në bashkëpunim me “Institutin Libertas” në Gjermani) (planifikuar në tetor 2010)**

Studentët mund të kryejnë një pjesë të studimeve nëpërmjet internetit, ndërsa kurse me prezencë në Pogradec mundësojnë leksione më intensive, shkëmbim idesh, mbështetje të mirë dhe këshillim për zhvillimin akademik të studentit.

### Studime Evropiane të orientuara në:

- Biznes dhe Ekonomi
- Administrim publik
- Juridik dhe OJF-të
- Diplomaci ndërkombëtare dhe integrim

## Fakte

Profesorë të kualifikuar nga Sh.B.A., Anglia, Franca dhe Gjermania

Gjuha bazë: gjuha anglize

Sistemi Dual: Alternon fazën e teorisë dhe praktikën (12 javë)

Plane për 2010: 4 javë studime në Gjermani në përfundim të semestrit të parë.

Për më shumë: [www.nehemia-uni.org](http://www.nehemia-uni.org)



# Miqtë e NEHEMIA-s

## Raport mbi punën e Shoqatës së Miqve NEHEMIA në vitin 2009

Viti filloi me një ngjarje të rëndësishme: më 25-28.02.2009 u zhvillua në Dyseldorf Kongresi i Drejtuesve të Krishterë. Shoqata u prezantua së bashku me Fondacionin NEHEMIA dhe Sëiss Foundation në një stendë në panairin e zhvilluar.

Nëpërmjet ndërmjetësimit të shoqatës u bë e mundur që një delegacion shqiptar i përbërë nga 10 persona të merrte pjesë në kongres. Ky delegacion u prit gjithashtu edhe nga Kryetarja e Bashkisë Dr. Strack-Zimmermann në bashkinë e qytetit të Dyseldorfit, ku Toni Gogu prezantoi punën e Fondacionit NEHEMIA në Shqipëri dhe i dorëzoi Dr. Strack-Zimmermann informacione dhe flamurin shqiptar.

Në disa nga takimet e kryesisë dhe të anëtarëve të shoqatës u krijuan kushtet për njohjen e shoqatës, por me ndryshimin e ligjit ishte i nevojshëm zhvillimi i një takimi të jashtëzakonshëm të anëtarëve për përshtatjen e statutit të shoqatës. Më në fund të gjitha barrierat u kapërcyen dhe më 13.11.2009 mundëm të merrnim paraprakisht njohjen ligjore si shoqatë jo-fitimprurëse.

Shumë shpejt u bë e mundur hapja e llogarisë bankare për t'i dhënë mundësi shumë anëtarëve dhe miqve për të marrë pjesë në nismën "Të bësh tre herë mirë".

Me një fletë shoqëruese në fletëpalosjen tonë kemi kërkuar donacione për NEHEMIA-n, pasi kemi marrë miratimin e trefishimit të të gjithë donacioneve deri më 31.12.2009 nga një donator bujar. Deri në fund të dhjetorit 2009 u regjistruan gati 9.000 € donacione. Një falenderim i veçantë të gjithë donatorëve!

Një falenderim gjithashtu edhe avokatit Z.Seitz për ndihmën e tij në formalitetet e nevojshme, gjithashtu edhe anëtarëve tanë, që morën kohë për takimet tona dhe u aktivizuan gjithashtu

personalisht për qëllimin e përbashkët.

Shoqata ka si qëllim të rëndësishëm zhvillimin e cilësisë në institucionet arsimore NEHEMIA që nga kopshti deri në Universitet, qoftë në Shqipëri, qoftë dhe në Gjermani nëpërmjet lidhjes së kontakteve me institucione arsimore dhe këshillimit me ekspertë.

Qëllimi për vitin 2010 është gjithashtu rritja e cilësisë në mësimin e gjuhës gjermane duke fituar eksperiencën e mësuesve nga Gjermania, duke qenë se NEHEMIA synon të bëhet shkollë DSD (Diploma e gjuhës gjermane).

Partneriteti me shkollën Landheim Schondorf am Ammersee ([www.landheim-schondorf.de](http://www.landheim-schondorf.de)) ka rezultuar i suksesshëm. Në gjysmën e dytë të vitit shkollor 2009/2010 përsëri dy nxënës nga shkolla NEHEMIA do të kalojnë disa muaj atje. Përsëri dy mësues të gjuhës gjermane mund të vizitojnë shkollën në Schondorf në qershor/korrik. Pas vizitave të para të mësuesve dhe nxënësve nga Schondorf në Pogradec synojmë që në vitin 2010 një grup nxënësish nga Schondorf të vijë në Shqipëri.

Duke qenë se shkolla Landheim Schondorf am Ammersee në vitin 2008 u njoh si shkollë e Round-Square ([www.round-square.de](http://www.round-square.de) ose [www.roundsquare.org](http://www.roundsquare.org)), krijohet mundësia për projekte në partneritete shkollore.

Shoqata numëron aktualisht 17 anëtarë.





## Në Buçimas

Dy projekte ambicioze ndërtimi janë duke u zhvilluar në Buçimas: ndërtesa e shkollës së mesme dhe një shtëpi për miqtë së bashku me një aneks.

Ndërtesat kanë një standard të lartë punimi, i pasuar nga një arkitekturë e bukur dhe rezistente ndaj tërmeteve, ambientaliste, sistem ekonomik për ngrohje dhe freskim, dhe pajisje të mjaftueshme të këndshme dhe praktike në përdorim.

Firma arkitekturale "hauserpartner" nga Egenhausen/Gjermani, së bashku me bashkëpunëtorë nga NEHEMIA, vullnetarë dhe mjeshtra nga Welheim/Gjermani formojnë një grup pune efektiv dhe profesional.

Shtëpia e miqve e përbërë nga 14 dhoma dhe apartamente, përfshirë këtu edhe një apartament për persona me aftësi të kufizuara, do të akomodojë miqtë e shumtë si edhe bashkëpunëtorët që mbështesin NEHEMIA për një kohë afat shkurtër apo afat mesëm. Data e përfundimit: shtator 2010!

Ndërtesa ekzistuese e kishës në Buçimas është pajisur plotësisht për leksione dhe aktivitete të universitetit, seminare etj, përfshirë këtu edhe pajisje të cilësisë së lartë për prezantime interaktive me figurë dhe zë, leksione nëpërmjet internetit, laboratorë kompjuterash, bibliotekë dhe shumë të tjera.

Qendra Kombëtare NEHEMIA në Buçimas përmbledh në total 8 ndërtesa dhe dy fusha sporti, në afërsi të bregliqenit të Ohrit. Përgjatë sezonit veror këto ambiente mund të jepen me qira për organizime kampesh, ekspozitash, pannaresh dhe shumë të tjera.

## Në Peshkëpi

Në kornizën e informacionit mbi projektin për zhvillimi komuniteti në fshatin Peshkëpi, tashmë dy ndërtesa janë gati të përfunduara: shtëpia e misionit dhe një ndërtesë e bukur si shtëpi kulture në dobi të komunitetit, që tashmë ka gjetur përdorim si mensë, për evente kulturore, etj.

## Në Stropckë

Një nga partnerët e NEHEMIA-s, kisha Apostolike inaguroi një ndërtesë për shërbesa frymërore dhe ndihmë sociale në fshatin Stropckë, në rrethin e Pogradecit. Ndërtesa e re e kishës është ndërtuar sipas projektit dhe planeve të aprovuara nga ndërtesa e kishës në Buçimas dhe Pogradec.

## Në Durrës dhe Pogradec

Restaurime dhe riparime janë kryer edhe në disa ndërtesa të tjera të NEHEMIA-s Durrës, Nishtulla si dhe shkolla Amaro Tan në Pogradec.

## Ndërtesa e shkollës së mesme

*(në ndërtim)*







Dy departamente brenda strukturës NEHEMIA kujdesen për një administrim të mirë dhe profesional të projektve operative, si dhe ofrojnë shërbime për palë të treta:

## Burimet Njerëzore dhe Operative, Komunikimi dhe Marrëdhëniet.

### Administrimi i Financave, Burimeve Njerëzore dhe Seminare.

Administrimi i burimeve njerëzore dhe administrative në NEHEMIA është krijuar për një bazë të sigurtë në gjitha aktivitetet e tij.

- Ligje dhe rregullore
- Procedura punësimi
- Kontrata dhe çështje ligjore
- Administrim financash dhe shumë të tjera

Fokusi ynë kryesor është trajnimi i brendshëm i bashkëpunëtorëve tanë. Në 2009 ata kanë pasur mundësinë që të marrin pjesë në disa seminare dhe trajnime:

#### Trajnime të brendshme:

- Manuali NEHEMIA
- Prezantimi i Fondacionit NEHEMIA
- Corporate Identity
- Metoda Löhn e vetëadministrimit
- Quick Books dhe Buxheti

#### Seminare:

- Leadershipi Kooperativ  
(*Clauss Siegfried Grommek, Gjermani*)
- Leadershipi Interaktiv  
(*Paul Donders, Hollandë*)
- MS-Project + Mind Map  
(*Sybille Brüggemann, Gjermani*)

Në 2010 do të fillojë „Akademia NEHEMIA e Lidërshiptit“ në bashkëpunim me zyrën e x-pand (Hollandë), duke ofruar një rreth të gjerë edukimi të mëtejshëm për çdo bashkëpunëtorë, deri në nivel drejtuesish.

### Mikpritja

Ne jemi shumë mirënjohës për shumë miq, trajnues dhe vullnetarë që na kanë vizituar nga vende si Gjermania, Zvicra apo SHBA.

Më të shumtit e tyre kanë gjetur akomodim në shtëpitë e misionit në Buçimas, Durrës, Peshkëpi dhe Has.

Numri i personave të akomoduar për 2009 ka qene rreth 800. Miqtë janë shumë të rëndësishëm për ne dhe dëshirojmë që të krijojme kushte komode për ta.

Vitin e ardhshëm me përfundimin e shtëpisë së miqve në Buçimas, premisa shumë të mira të standardeve të larta do të pasojnë dhe do të na lehtësojnë një shërbim akoma edhe më cilësor për miqtë tanë.





## Ambiente

Ambientet e këndshme të Qendrës NEHEMIA në Buçimas jo vetëm strehojnë një sasi të madhe projektesh sociale dhe arsimore, por është e mundur që të jepen për përdorim nga organizata dhe institucione të tjera, veçanërisht gjatë periudhës tremujore të sezonit veror.

### **Ndërtesa e Shkollës “Horst Koschmieder” dhe Shkolla e Mesme (në ndërtim)**

Këto ndërtesa ofrojnë hapësira për kampe verore përgjatë sezonit të pushimeve. Ndërtesat mund të transformohen në ambiente komode për grupe deri në 100 persona duke ofruar kushte të përshtatshme si akomodim, higjenë, fushë sporti, salla takimesh etj.

### **Ndërtesa “Alfred Wenig”**

Si ndërtesë multifunksionale, kjo kishë përfshin edhe një auditor që përdoret për prezantime, salla takimesh ose një sallë kompjuterash ideale për seminare, konferenca, kampe etj.

E gjithë ndërtesa është e pajisur me lidhje interneti dhe sistem ngrohjeje, dhoma të ndryshme të pajisura me tabela interaktive prezantimesh, videoprojektorë, sistem zëri, sistem përkthimi simultan dhe një bibliotekë.

Gjithashtu përfshihet edhe një kafene për miqtë, nxënësit, studentët etj.

### **Fushat e sportit**

Dy fusha të ndara sporti të pajisura me tartan dhe bar të cilësisë së lartë, gjithashtu një pistë vrapimi, një gropë për kërcim për së gjati dhe sistem ndriçimi për natën ofrojnë kushte ideale për aktivitete sportive dhe argëtimi në kompleksin NEHEMIA, në Buçimas.

## Zyra e Medias

Zyra jonë e medias prodhon produkte për prezantime të ndryshme, Corporate Identity dhe është përgjegjëse për marrëdhëniet me publikun për Fondacionin NEHEMIA. Këtu përfshihen zgjidhje grafike, video dhe internet.

Disa nga produktet tona janë:

- Raporte Vjetorë
- Broshura, fletëpalosje, postera
- Filmime dhe montazh video
- Organizim eventesh
- Zgjidhje për Teknologji Informacioni
- Brand



*“Duke dhënë jemi edhe ne të bekuar.”*







## Projekte Sociale dhe Mjekësore të NEHEMIA-s

Klinika NEHEMIA - Licensë Nr. 3391, 7 korrik 2006  
nga Ministria e Shëndetësisë

Shërbime të përkujdesit komunitar (Pogradec, Bishnicë, Durrës, Gjirokastrë, Buçimas, Peshkëpi) –  
Licensë Nr. LN-0408-10-2009, 16 tetor 2009  
nga Qendra Kombëtare e Liçensimit

Leje për ushtrimin e profesionit të infermierisë – mamisë – fizioterapisë– Regj. N. 07-17,  
3 nëntor 2009  
nga Ligji i Infermierisë Shqiptare (Licensë individuale)

## Edukimi NEHEMIA

Shkolla fillore NEHEMIA - Licensë Nr. 5342 Prot. No. 72, 10 tetor 1998  
nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës

Kopshti NEHEMIA - Licensë Nr. 4524 Prot. No. 160, 23 nëntor 1999  
nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës

Shkolla e Mesme NEHEMIA - Licensë Nr. 4088 Prot. No. 300, 5 tetor 2000  
nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës

Shkolla e Mesme NEHEMIA - Licensë Nr. 6194 Prot. No. 288, 14 shtator 2004  
nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës

Shkolla e Mesme me kohë të shkurtuar NEHEMIA - Licensë Nr. 7001 Prot. No. 383, 10 tetor 2006  
nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës

Universiteti NEHEMIA - Licensë, 4 qershor 2008 me urdhër Nr. 2300/1 Prot. Nr. 830  
nga Këshilli i Ministrave

Shkolla AMARO TAN - Licensë Nr. 5059, 3 dhjetor 2002  
nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës

Cikli i Mesëm Shkolla AMARO TAN - Licensë Nr. 3132 Prot. Nr. 173, 15 maj 2006  
nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës

Kurse nga Fondacioni NEHEMIA Pogradec - Licensë Nr. 687, 26 mars 2008  
nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

## Regjistrime

NEHEMIA është regjistruar në Shqipëri si një  
Fondacion jo fitim prurës, humanitar.

Themeluesit janë dy organizata humanitare  
gjermane “NEHEMIA Christian Aid Ministries”  
dhe “Action Committee for Persecuted Chris-  
tians, AVC” (Anëtare e Vëllazërisë Pentakos-

tale), të dyja me qendër në Nidda (Gjermani).  
NEHEMIA është regjistruar për herë të parë në  
20 Shkurt, 1992 nga Minsitria Shqiptare e  
Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Për shkak të ndryshimit të Ligjit, Fondacioni  
NEHEMIA u ri-regjistrua në 13 Maj, 2002 në  
Gjykatën në Shkallë Rrethi, Tiranë me vendim  
nr.5/1.





Fondacioni NEHEMIA është një organizatë humanitare jo qeveritare, e cila mbështetet financiarisht nga donatorë vullnetarë, ndihma dhe puna e individëve të ndryshëm, kisha dhe organizata të ndryshme. Përveç mbështetjes financiare ne marrim gjithashtu edhe:

## Mbështetje frymërore

Ne besojmë tek fuqia e lutjeve. Për këtë arsye ne i vlerësojmë lutjet e besimtarëve të krishterë si një nga mënyrat më efektive të mbështetjes që na jepet për projektet tona në të gjithë Shqipërinë.

## Këshilla profesionale

Ne iu jemi shumë mirënjohës individëve të veçantë, për këshillat nga eksperiencia e tyre e pasur ku përfshihen: Drejtues misionesh dhe administratorë të sukseshëm, të cilët na kanë ndihmuar të realizojmë vizionin tonë.

## Ndihmë praktike

Shumë persona janë të gatshëm të ofrojnë edhe ndihmën e tyre praktike nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme. Në afate të shkurtra kohore, gjatë pushimeve të tyre, shumë nga partnerët tanë nga Gjermania dhe Zvicra ndihmojnë praktikisht.

Pjesa më e madhe e donacioneve tona vjen nga Organizata AVC dhe NEHEMIA që ndodhet në Gjermani dhe Zvicër. Projekte të ndryshme financohet drejtpërdrejt nga Organizatat partnere dhe gjithashtu drejtohen vetë nga ta.

Pjesa më e madhe e projekteve tona i mbulojnë shpenzimet e tyre nga të ardhurat që nxjerrin vetë si për shembull, Shkolla NEHEMIA. Paratë e mbledhura në kishë përdoren për punën shpirtërore dhe për të ndihmuar të varfërit.

Ne përpiqemi të përdorim donacionet me efektivitet dhe bazohemi tek:

- *Kontrolle financiare vjetore nga auditorë të licensuar shiptarë dhe të huaj.*
- *Transparencë nëpërmjet raporteve të rregullta për financat dhe aktivitetet.*
- *Kontrolle të vazhdueshme financiare brenda Fondacionit.*
- *Kualifikime të vazhdueshme të administratorëve dhe të llogaritarëve tanë.*
- *Programme dhe teknika kompjuterike moderne për llogarimbajtjen dhe administratën*





Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëlidhur të Fondacionit NEHEMIA, të cilat përfshijnë Bilancin Kontabël më datë 31 Dhjetor 2009, pasqyrat përkatëse të të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin e veta dhe pasqyrën e fluksit të parasë për ushtrimin e mbyllur në atë datë si dhe një përmbledhje të metodave kontabël të rëndësishme dhe shënime të tjera anekse.

Drejtimi është përgjegjësi për përgatitjen e paraqitjes së sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me parimet kontabël gjerësisht të pranura në Republikën e Shqipërisë.

Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, vënien në zbatim dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm, paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare që janë pa anomali materiale, duke zbatuar metodat e përshtatshme kontabël si dhe për të bërë vlerësimet kontabël, që janë të arsyeshme për rrethanat e dhëna. Përgjegjësia jonë është që, bazuar në auditimin e kryer, të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare. Ne e kryem auditimin në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit.

Këto standarde kërkojnë që të zbatojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe kryejmë auditimin tonë për të marrë sigurinë e arsyeshme që pasqyrat financiare nuk përmbajnë anomali materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare mbi bazën e testeve, të evidencës që mbështet

shumat dhe informacionet e dhëna në pasqyrat financiare.

Auditimi përfshin gjithashtu vlerësimin e parimeve kontabël të përdorura dhe të çmuarjeve të rëndësishme të bëra nga Drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare. Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat e opinionit tonë të auditimit.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare japin një imazh të vërtetë dhe të sinqertë të gjendjes financiare të Fondacionit NEHEMIA, më datë 31 Dhjetor 2009 dhe të rezultatit financiar dhe të fluksit të parasë për ushtrimin e mbyllur, në përputhje me parimet kontabël gjerësisht të pranura në Republikën e Shqipërisë.

Pogradec, 28 janar 2010

AUDITOR

E.K.A. Bashkim KILLO



*“Ne praktikojmë transparencë të plotë të financave për të garantuar besimin e donatorëve dhe të klientëve.”*





## Pasqyra e aktiviteteteve

Pasqyra e aktiviteteteve për fundvitin 31 dhjetor 2009

	LEK	EU 130
<b>SUPPORT AND REVENUE</b>		
DONATIONS	18,249,075	140,378
DONORS	171,542,957	1,319,561
MISCELLANEUS INCOME	3,834,526	29,496
SERVICE INCOME	25,830,220	198,694
<b>Total Support and Revenue</b>	<b>219,456,778</b>	<b>1,688,129</b>
<b>EXPENSES</b>		
COMMUNICATION	4,555,557	35,043
CARS / TRANS & TRAVEL	15,819,831	121,691
OPERATIVE EXPENSES	60,476,947	465,207
PERSONEL	65,824,727	506,344
<b>Total Expenses</b>	<b>146,677,062</b>	<b>1,128,285</b>
<b>OTHER REVENUE AND EXPENSE</b>		
<b>Other Revenue</b>		
HUMANITARIAN ITEMS INCOME	4,730,850	36,391
<b>IN KIND INCOME</b>	43,747,716	336,521
OTHER INCOME	15,767,572	121,289
<b>Total Other Revenue</b>	<b>64,246,138</b>	<b>494,201</b>
<b>Other Expense</b>		
HUMANITARIAN ITEMS DISBURSED	3,716,850	28,591
OTHER EXPENSE	0	0
<b>Total Other Expense</b>	<b>3,716,850</b>	<b>28,591</b>
<b>Total Other Revenue and Expense</b>	<b>60,529,288</b>	<b>465,610</b>
<b>CHANGE IN NET ASSETS</b>	<b>133,309,003</b>	<b>1,025,454</b>

Shuma në Euro është llogaritur sipas kursit të shkëmbimit 2009. (130 lek/1Euro)





## Pasqyra e gjendjes financiare

Pasqyra e gjendjes financiare për fundvitin 31 dhjetor 2009

	LEK	EU 130
<b>ASSETS</b>		
Current Assets		
Cash Bank	112,018,260	861,679
Cash on Hand	1,451,022	11,162
Accounts Receivable	4,839,744	37,229
<b>Total Current Assets</b>	<b>118,309,027</b>	<b>910,069</b>
Fixed Assets		
Land	81,703,802	628,491
Tools and Machinery	18,465,921	142,046
Less: Accumulated Depreciation	-14,491,824	-111,476
Equipment	25,085,649	192,967
Less: Accumulated Depreciation	-19,502,164	-150,017
Automobiles	23,298,220	179,217
Less: Accumulated Depreciation	-15,986,261	-122,971
Buildings	475,517,389	3,657,826
Less: Accumulated Depreciation	-169,066,457	-1,300,511
<b>Total Fixed Assets</b>	<b>405,024,275</b>	<b>3,115,571</b>
<b>TOTAL ASSETS</b>		
<b>LIABILITIES AND NET ASSETS</b>		
<b>LIABILITIES</b>		
Insurance Payable	1,401,969	10,784
Other Tax Payable	480,825	3,699
Accounts Payable	11,615,615	89,351
<b>TOTAL LIABILITIES</b>	<b>13,498,409</b>	<b>103,834</b>
<b>NET ASSETS</b>		
Total Fund Balance	376,525,889	2,896,353
Net Income	<u>133,309,003</u>	1,025,454
<b>TOTAL NET ASSETS</b>	<b><u>509,834,893</u></b>	<b>3,921,807</b>
<b>TOTAL NET ASSETS AND LIABILITIES</b>	<b><u><u>523,333,302</u></u></b>	<b><u><u>4,025,641</u></u></b>





## Vizitoni faqen tonë të internetit!



[www.nehemia-al.org](http://www.nehemia-al.org)

Për më shumë informacion rreth projekteve, historisë dhe gjithçka tjetër mund të informoheni në faqen tonë të internetit.

Në vitin 2010 faqja e internetit të do marrë një fytyrë të re, e cila do jetë më e orientuar ndaj përdoruesit dhe më interaktive.

Faqja e re do të publikohet së shpejti!





## Llogari Bankare dhe Kontakte

### Gjermani

AVC  
Commerzbank Münchberg  
BLZ 780 400 81  
Kto: 311 440 200  
IBAN:  
De27 7804 0081 0311 4402 00  
BIC: COBADEFF780

### Miqtë e NEHEMIA-s (Gjermani)

VFBN-Nehemia-Förderverein  
Raiffeisenbank Weilheim  
BLZ: 701 696 02  
Konto Nr.: 150 100

### Misioni i Kryqit të Artë (GKM, Gjermani)

GKM e.V.  
Raiffeisenbank Weilheim  
BLZ: 701 696 02  
Konto Nr.: 199 966

IBAN: DE28 7016 9602 0000 1999 66  
BIC: GENODEF1WM1

### Zvicër

AVC Hilfswerk  
Credit Suisse  
2501 Biel  
Konto 214 992-81  
or: Postkonto 25-11156-1

### Shqipëri

NEHEMIA Found.  
ProCredit Bank  
Pogradec Branch/Albania  
Kto: 55-002422-00-02  
Swift: FEFAALTRXX

### SH.B.A.

For donations from the  
United States please visit  
our cooperating mission  
online: [www.gba.org](http://www.gba.org)

### Qendra Kombëtare NEHEMIA, Shqipëri

Rruga Nehemia/ Buçimas/Pogradec  
Tel: +355 (0) 868 20004  
Fax: +355 (0) 868 20005  
E-mail: [nehemia@nehemia-al.org](mailto:nehemia@nehemia-al.org)







RAPORTI VJETOR NEHEMIA 2009

TË GJITHA MATERIALET E PREZANTUARA NË KËTË DOKUMENT  
JANË PRONË E FONDACIONIT NEHEMIA.  
PA AUTORIZIMIN E FONDACIONIT NEHEMIA NUK LEJOHET  
SHTYPJA APO RIPRODHIMI I KËTIJ MATERIALI.